



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS
PROCESVERBAL

KONSULTIMIT PUBLIK

PËR

**DHËNIEN NË PËRDORIM TË NJË SIP.0,5 HA, NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR, PËR
OBJEKTIN HEC “MALLA” (SHTESE) NË FUNKSION TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË
“GJURR REÇ” SH.P.K**

I mbajtur sot me datë 27.06.2024, ora 14:00, në fshatin Arrëz. U zhvillua konsultimi publik lidhur me projektvendimin për dhënie në përdorim të një sip. 0.5 ha, Hec Malla (shtesë). Nga ana e bashkisë Kukës morën pjesë: A.M, S.M, S.H, specialist nga drejtoria e pyjeve dhe kullotave, administrator z. A.M.

Morën pjesë banorë të zonës, kryetari i fshatit. Takimi hapet nga kryetari i këshillit z. A.M, i cili shpjegon projektvendimin. Bëhet fjalë për një shtesë prej 0.5 Ha. Kërkojmë mendimin tuaj lidhur me këtë vendimmarrje. Pasqyroni shqetësimet tuaja në lidhje me aktivitetin e kësaj shoqërie.

Kryetari i fshatit: Ne jemi dakord për zhvillimin nëse të gjithë banorët janë dakord.

R.S: Së pari duam të dimë nga e merr ujin ky subjekt për të zhvilluar aktivitetin e tij?

S.H: Ne po flasim për tokën që ka në pronësi bashkia. Në tokat private bëhet marrëveshje mes banorëve dhe subjektit. Ne po konsultohemi sot në lidhje me pronën e bashkisë.

R.S: Të shtrihet tubacioni për vaditje. Për çdo familje duhet një mundësi për vaditje. Duhet një pusetë e re.

A.C: Neve nuk na e kanë vënë në dispozicion projektin. Si mund të merret leja pa u zbardhur projekti?

Përfaqësues nga firma: Asnjë banorë nuk do të preket